



Demonstratat publike – Plani i orës

Detyrat e nxënësve

- Të kuptohet rëndësia themelore e demonstratave publike në garantimin e lirisë së shprehjes, veçanërisht e grupeve të paprivileguara dhe të margjinalizuara.
- Me ndihmën e demonstratës publike të bëhen të njohura temat që hapen për konfliktin ndërmjet shprehjes së lirë dhe rendit publik.
- Të kuptohen problemet afatgjata që krijohen kur bëhet baraspeshë ndërmjet forcave të policore dhe shprehjes së lirë gjatë demonstratave publike.
- Të analizohet shkaqet që e mbështetin dhe e kundërshtojnë të drejtën e pushtetit që të ketë fuqi të ndalojë demonstratë publike pa leje.
- Të gjenden fushat e pajtueshmërisë dhe mospajtimit me nxënësit e tjerë.
- Të merret vendim, individual ose grupor, se a duhet të ketë shteti fuqi që ta ndalojë demonstratën publike pa leje; vendimet e marra të mbështeten në bazë të dëshmive dhe të menduarit korrekt.
- Kur merren vendime në lidhje me një demokraci, të mendohet në lidhje me vlerën e diskutimit të argumentuar.

Çështje për diskutim të argumentuar

A duhet të ketë demokracia jonë fuqi që të ndalojë demonstrata publike pa leje?

Materialet

- Procedurat e orës
- Materiali nr. 1 – Udhërrëfyes për diskutime të argumentuara
- Materiali nr. 2 – Aktivitete për diskutime të argumentuara
- Materiali nr. 3 – Qasja e nxënësve ndaj diskutimit të argumentuar
- Copë leximi
- Burime të zgjedhura
- Pyetje për diskutim të argumentuar me argumente të parashtruara
(*me zgjedhje – përdoreni nëse nxënësit e kanë vështirë të japin argumente ose nëse koha është e kufizuar*)



Demonstratat publike – Copë leximi

1 Në nëntor të vitit 2004 kryeministri i atëhershëm i Ukrainës u shpall fituesi i zgjedhjeve,
2 por, marrë në përgjithësi, vëzhguesit vendorë dhe bashkësia ndërkombëtare vërejtën parregullsi.
3 Prandaj mijëra demonstrues u tubuan pa lejen e pushtetin në Sheshin e Pavarësisë në kryeqytetin
4 e ngrirë e të mbuluar më borë Kiev. Demonstruesit refuzuan të shkojnë në shtëpi derisa nuk
5 shpalleshin zgjedhje të reja. Ata qëndruan aty, këndonin këngë dhe u shoqëruan pa dhunë në
6 protestën kundër procesit zgjedhor. Pasi protestuan disa ditë, Gjykata Supreme i shpalli të
7 pavlefshme rezultatet e nëntorit dhe urdhëroi të organizohet zgjedhje të reja. “Revolucioni i
8 Portokalltë”, i emërtuar kështu sipas ngjyrës që e zgjodhën protestuesit, mundësoi zgjedhje më
9 korrekte në dhjetor 2004; atëherë fitoi kandidati i opozitës.

10 Kur qytetarët nuk pajtohen me pushtetin, njëra nga mënyrat më të mira që ta shprehin
11 këtë është që të demonstrojnë publikisht me qytetarët e tjerë. Ndonjëherë – në Ukrainë më 2004,
12 në Rumani më 1991, në Azerbajxhan më 1988 dhe në Filipine më 1986 – këto demonstrata nuk
13 janë penguar dhe kështu kanë mundësuar që në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndërrohet pushteti.
14 Më parë, si në vitin 1991 në Sheshin Tijananmen dhe në Çikago më 1968, qeveritë vendosnin se
15 a janë këto demonstrata kërcënim për sigurinë publike dhe ato i shtypnin me ndihmën e policisë
16 dhe të ushtrisë.

17 Ndryshimi ndërmjet të drejtave të qytetarëve që të shoqërohen dhe përgjegjësia e qeverisë
18 që ta ruajë sigurinë e njëjës nga çështjet më problematike në lidhje me shprehjen e mendimit të

19 lirë në cilëndo shoqëri. Kjo pyetje është posaçërisht problematike në një demokraci ku pushteti e
20 ka patjetër ta dëgjojë dhe të përgjigjet në zërin e qytetarëve.

21

22 **Liria e lashtë dhe elementare**

23 Tubimi i njerëzve me qëllim që të diskutojnë për probleme dhe ta shprehin pakënaqësinë
24 e tyre ndaj pushtetit është i lashtë mbase aq sa është i vjetër edhe vetë rregullimi i pushtetit.
25 Përdorimi i atyre tubimeve për protesta kundër procedurave të pushtetit njësoj ka histori të gjatë
26 juridike, ndërsa këto tubime janë të patjetërsueshme për liri të tjera, si liria e besimit dhe liria e
27 fjalës së lirë. Për shembull, Lëvizja Laburiste Amerikane, Lëvizja Moderne e të Drejtave
28 Qytetare dhe Lëvizja për Jetë kanë përdorur tubime publike që t'i promovojnë kauzat e tyre.

29 Demonstratat publike janë formë unikate dinamike e të shprehurit. Ato mundësojnë
30 kontakt personal ndërmjet folësit dhe dëgjuesit, nxisin solidaritet dhe mbështetje të ndërsjellë
31 ndërmjet demonstruesve dhe lejojnë që demonstruesit ta shfaqin përkushtimin dhe mbështetjen e
32 njerëzve nga jashtë. Meqë për demonstratë nuk duhen të holla, që janë të nevojshme për
33 emisione televizive, fushata mediale ose reklama të gazetave, ata që kanë pak ose që nuk kanë
34 fare fuqi ekonomike ose politike më shpesh i zgjedhin pikërisht ato si mënyrë të veprimit të tyre.

35 Neni 20 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, që është miratuar më 1948 nga
36 Asambleja e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e përfshin sigurinë se “se secili ka të drejtë
37 të lirisë për tubim të qetë dhe shoqërim”. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës amendamenti i
38 parë i Kushtetutës thotë se “Kongresi nuk do ta bëjë asnjë ligj... që e ndalon ... të drejtën e
39 njerëzve që të tubohen në mënyrë të qetë dhe të kërkojnë nga Qeveria të ndërmarrë hapa për

40 përmirësimin e problemeve”. Qytetarët e praktikojnë, ndërsa qeveritë e respektojnë këtë të drejtë
41 në shkallë të ndryshme gjithkund në botë.

42

43 **Baraspeshë e vështirë që nga fillimi**

44 Gjithsesi që secilës shoqëri, me qëllim të funksionimit, i duhet një rend. Njerëzve u duhet
45 dhe pritet që ta kenë të drejtën elementare të jetës pa frikë nga sulmet ndaj tyre personalisht, ndaj
46 pasurisë së tyre ose ndaj ndërgjegjes së tyre. Policia e siguron këtë mbrojtje. Pa këto fuqi “liria e
47 të shprehurit” në demonstratat publike lehtë mund të shndërrohet në sundim të masës. Për nga
48 natyra e tyre zbatuesit e ligjeve – policia dhe ushtria – mëtojnë drejt mbështetjes së rendit aktual.
49 Kështu ata shpesh i kundërshtojnë demonstratat që i kundërvihen gjendjes *status quo* dhe mund
50 të sjellin deri në parregullsi.

51 Që të mbahet rendi – dhe shpesh të përkufizohet shprehja e padëshirueshme e
52 pakënaqësisë – pushteti përdor metoda të ndryshme që t’i kontrollojë demonstratat publike. Ato
53 përfshijnë kërkim të lejes; përcaktim të kohës, vendit dhe mënyrës së tubimit; si dhe përcaktim të
54 rolit specifik për policinë në mbajtjen e rendi. Tashmë një shekull në Shtetet e Bashkuara të
55 Amerikës debatohet se ku duhet të vihet vija ndërmjet lirisë së shprehjes dhe kufizimit racional,
56 por përfundime ende nuk janë arritur. Siç ka shkruar njëherë gjykatësi suprem në Gjykatën
57 Supreme të SHBA-ve, Feliks Frankfurter,¹ “konflikti ndërmjet të folurit dhe interesave të tjera

¹ Felix Frankfurter

58 është problem po aq i vazhdueshëm sa është edhe shqetësues” (Niemothko kundër Merilendit²
59 (1951)].

60 Megjithatë Gjykata Supreme në SHBA i ka zhvilluar disa parime të punës. Për shembull,
61 Gjykata e ka pranuar të drejtën e pushtetit që t’i rregullojë sipërfaqet e jashtme dhe ta mbajë
62 rendin publik; demonstruesit nuk mund ta zënë gjithë rrugën ku kalojnë makinat. Nga ana tjetër,
63 pushteti nuk mund të ndalojë fjalim vetëm sepse atij nuk i pëlqen ajo që flitet. Nëse, për
64 shembull, pushteti u jep leje grupeve proqeveritare që të mbajnë tubime të hapura në ndonjë park
65 publik, atëherë ajo nuk mund t’ua shkurtojë këtë të drejtë grupeve që protestojnë kundër
66 veprimeve të qeverisë.

67 Edhe vende të tjera ballafaqohen me këto çështje. Në pranverën e vitit 1989 mijëra
68 studentë kinezë u mblodhën në sheshin Tijananmen të kryeqytetit Pekin që të demonstrojnë për
69 reforma demokratike. Me studentët u bashkuan edhe punëtorët e fabrikave, nëpunës të
70 administratës dhe intelektualë liderë, që gjithsej bënë të mblidheshin thuajse një milionë njerëz.
71 Në fillim qeveria kineze i toleronte protestat, por pastaj i gjykoi, madje në gjysmën e dytë të
72 majit shpalli gjendje lufte. Demonstruesit kërkonin që paria e pushtetit të japë dorëheqje, por
73 vetëm për një natë në fillim të qershorit, tanket e dërguara nga qeveria i shkelën demonstruesit, i
74 përzunë ata që mbetën dhe i burgosën udhëheqësit e nxënësve. Qeveria kineze ndërmori masa që
75 ta shtypë atë që ajo e quajti “kryengritje kundërrevolucionare”.

76 Qeveritë ndonjëherë dinë ta pengojnë përdorimin e ndonjë të drejte, këtë përmes
77 rregullave dhe procedurave drejtuese. Neni 49 i Kushtetutës së Republikës së Azerbajxhanit
78 përcakton se “secili njeri do ta ketë të drejtën e tubimit, mbajtjes së mbledhjeve, tubimeve,

² Niemothko v. Maryland

79 demonstratave, marsheve rrugore, protestave të qeta dhe pa armë, gjithë kjo me njoftim paraprak
80 të organeve relevante të shtetit.” Megjithatë në vitin 1998, kuvendi i shtetit (Kuvendi i
81 Republikës së Azerbajxhanit) e miratoi Ligjin për lirinë e tubimit, në të cilin thuhet se secili që
82 organizon çfarëdo tubimi është i detyruar që ta informojë me shkrim trupin relevant të pushtetit
83 ekzekutiv së paku pesë ditë para tubimit të planifikuar. Ligji po ashtu e pengon lirinë e tubimit
84 në rast të grusht shtetit ose në rast të në rast të kërcënimit të sigurisë nacionale të shtetit. Sipas
85 shumë ekspertëve, ky ligj është në kundërshtim me lirinë e Kushtetutës së Azerbajxhanit.

86 Në Rusi liderët shpresojnë se, strukturat që u japin mundësi qytetarëve që ta shprehin
87 mendimin e tyre, se pikërisht ato do t’i bëjnë demonstratat të panevojshme. Në vitin 2005
88 Dimitri Medvedev, shef i kabinetit të Kryetarit Putin, u shpreh në lidhje me demonstratat që sapo
89 kishin përfunduar: “Demonstratat në rrugë ishin reagim normal i njerëzve të hidhëruar...
90 Megjithatë më mirë është që diskutimet për masat e nevojshme të bëhen përmes procedurave
91 legjitime sesa në rrugë, ndërsa që të bëhet kjo, duhet të krijojmë mekanizma funksional për
92 komunikim ndërmjet opinionit dhe pushtetit.”

93

94 **Kufizimi i demonstratave publike: mbështetës dhe kundërshtarë**

95 A kanë fuqi qeveritë demokratike që t’i ndalojnë demonstratat publike që mbahen pa
96 leje?

97 Njerëzit që e mbështesin qëndrimin për ndalimin e demonstratave për të cilat nuk është
98 marrë leje thonë se kërkesa për leje nga pushteti krijon një baraspeshë racionale ndërmjet rendit
99 dhe lirisë. Kërkimi i lejes nuk do të thotë se qeveria ka fuqi arbitrare të lejojë ose të ndalojë

100 demonstrim publik. Në vend të kësaj, kërkimi i lejes i mundëson qeverisë që ta përmbushë
101 përgjegjësinë e vet për zbatim të barabartë të ligjit: secili i ndjek rregullat e njëjta.

102 Mbështetësit po ashtu argumentojnë se me qëllim që një ligj të jetë i zbatueshëm, ai
103 patjetër duhet të mund të funksionojë. Nëse policia nuk mund t'i zhvendosë ose t'i kontrollojë
104 njerëzit në vende publike, shoqëria vihet në rrezik. Meqë masat e njerëzve janë jostabile,
105 demonstratat e qeta shumë lehtë mund të kalojnë në masë të dhunshme të njerëzve. Kërkimi i
106 lejes krijon kornizë racionale në të cilën edhe pushteti edhe demonstruesit mund të marrin
107 vendime.

108 Kundërshtarët e kërkesës së lejes thonë se njerëzit që tubohen në mënyrë të qetë që të
109 diskutojnë ose të protestojnë kundër diçkaje, atyre nuk u duhet leje nga po ai pushtet me të cilin
110 ata mbase e kanë problemin. Secili ligj që kërkon leje për të organizuar demonstrata në vende
111 publike paraqet kufizim jokorrekt të një lirie themelore të shoqërisë demokratike. Vendimi se a
112 do të lejohen ose ndalohen demonstratat publike në thelb është vendim politik: për atë liri nuk
113 duhet të lejohet që të vendosë ndonjë nëpunës.

114 Kundërshtarët po ashtu thonë se për dallim nga gazetat dhe televizioni, që janë medime
115 të të fuqishmëve dhe pasurve, demonstratat publike janë medium për të varfrit, radikalët dhe
116 njerëzit e marginalizuar. Këta njerëz vështirë mund të presin ta fitojnë lejen e njëjtë si njerëzit
117 që e mbështetin pushtetin e vendosur. Me qëllim që dikush ta dëgjojë edhe zërin e tyre, ata duhet
118 të mund të protestojnë, të parakalojnë dhe të demonstrojnë në vende publike ku dhe kur të jetë e
119 nevojshme. Përdorimi i vendeve publike për këso qëllimesh derisa ruhet paqja dhe rendi, kjo nuk
120 duhet të kontestohet.

121 Mbështetësit e idesë se pushteti duhet të ketë fuqi t'i pengojë demonstratat e realizuara pa
122 leje e kundërshtojnë këtë duke thënë se sipërfaqet publike nuk janë edhe sipërfaqe në të cilat

123 sundon parregullsia. Ashtu si secili qytet që më të drejtë kryen kontroll në komunikacion, është
124 racionale që përmes kërkimit të lejes qeveria ta ruajë rendin. Privilegji i disa qytetarëve që në
125 mënyrë publike të mblidhen me qëllim që t'i këmbejnë mendimet e tyre patjetër duhet të
126 rregullohet për të mirën e të gjithë qytetarëve, sepse ky është privilegj relativ, e jo absolut.

127 Mbështetësit po ashtu e vërejnë se në epokën e komunikimit “momental” rrallë ndodhë
128 që ashtu shpejt të ndodhin ngjarje për të cilat pushteti nuk mund të japë përgjigje me kohë. Një
129 leje mund të shqyrtohet dhe të miratohet mjaft shpejt që ashtu të respektohen nevojat legjitime të
130 qytetarëve për shprehje të lirë. Kundërshtarët pajtohen se, ashtu si në Kiev në vitin 2004, koha e
131 mbajtjes së demonstratave është gjëja më e rëndësishme. Ata frikohen se veprimet qeveritare të
132 dhënies së lejes, ashtu si në Azerbajxhan, krijojnë zgjatje që praktikisht paraqet ndalesë
133 qeveritare për tubimet e qytetarëve.

134 Thënë shkurtimisht, se si i rregullojnë qeveritë demonstratat publike, kjo do të mbetet
135 pyetja më kundërthënëse gjithkund ku ka demokraci.



Demonstratat publike – Burimet e zgjedhura

„Kushtetuta e Azerbajxhanit”, Projekt i të drejtës kushtetuese ndërkombëtare
<http://www.oefre.unibe.ch/law/icl/aj00000.html>.

Konventa për të Drejtat Themelore të Unionit Evropian: neni 12, Liria e tubimit dhe shoqërimit,
Gazeta zyrtare e komuniteteve evropiane (2000)
http://europa.eu.int/comm/external_relations/human_rights/doc/charter_364_01en.pdf.

Çikago kundër Moralesit etj. 527 SHBA 41 (1999),
<http://laws.findlaw.com/us/000/97-1121.htm>.

Servisi Gjurmues i Kongresit, “Amendamenti i parë: shënime”, në *Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës: analiza dhe interpretime* (Uashington DC: Biblioteka e Kongresit, 1992; versioni i plotësuar në vitin 2000 nga Fajndlo), gjendet në:
<http://caselaw.lp.findlaw.com/data/constitution/amendment01/06.html#1> (fq. 6, 7, 10, 12, 18, 20 dhe 21).

Emerson, Tomas I., “Rendi i brendshëm: tubimet, demonstratat, trysnia”, në *Sistemin e lirisë së shprehjes* (Nju Jork: libra të vjetra, reparti i *Random House*, 1970), fq. 285-388 (veçanërisht 285-292 dhe 386-388).

“Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut: neni 11, Liria e tubimit dhe shoqërimit”
(Strasburg: Këshilli i Evropës, 1950) <http://conventions.coe.int/treaty/en/Treaties/Html/005.htm>.

“Konventa Evropiane Sociale: pjesa II, neni 5, E drejta e organizimit” (Strasburg, Francë; Këshilli i Evropës, 1961), <http://conventions.coe.int/treaty/en/Treaties/Html/035.htm>.

“Liria e tubimit dhe shoqërimit të qetë”, (Strasburg, Francë; Këshilli i Evropës).
http://www.coe.int/T/e/human_rights/awareness/6_Human_Rights_Issues/6_peaceful_assembly.asp.

Haga kundër Komitetit për Organizim Industrial, 307 SHBA 496 (1939),
<http://laws.findlaw.com/us/307/496.html>.

Medvedev, Dimitri, “Me të vërtetë e kemi patjetër ta ruajmë këtë shtet të madh”, *revista “Eskpert”*, nr. 13, (4 prill, 2005) <http://www.kremlin.ru/eng/text/publications/2005/04/86313.shtml>.

Niemoshko kundër Merilendit, 340 SHBA 268 (1951), <http://laws.findlaw.com/us/340/268.html>.

Redish, Martin X., “Mbështetja publike joligjore dhe liria e fjalës”, në *“Logjikën e diskriminim: liria e shprehjes dhe era e MekKartit”*, Stanford, Kaiforni: *Stanford University Press* (2005), fq. 63-131 (veanërisht 78-106).

Shalsvort kundër Birmingemit, 394 SHBA 147 (1969), <http://laws.findlaw.com/us/394/147.html>.

“Deklarata universale për të drejtat e njeriut: neni 20” (e drejta e tubimit dhe shoqërimit të lirë; liria e shoqërimit të detyrueshëm) (Nju Jork; Kombet e Bashkuara, 1948)
<http://www.un.org/Overview/rights.html>.



Demonstratat publike – Çështje për diskutim të argumentuar me argumente të parashtruara

A duhet të ketë demokracia jonë fuqi që t'i ndalojë demonstratat publike pa leje?

Argumente për mbështetjen e çështjes së diskutimit të argumentuar

1. Njerëzit nuk mund t'i realizojnë të drejtat e tyre pa një shoqëri të rregulluar në të cilën ata do të mund të shpreheshin. Pa pushtet, me opinionin nuk do të sundojnë ligjet, por më të fuqishmit ose më të zëshmit. Kërkimi i lejes për demonstratë publike krijon baraspeshë racionale ndërmjet nevojave të rendit dhe lirisë në një shoqëri demokratike.
2. Dhënia paraprake e lejes nuk i jep fuqi pushtetit për vendosje arbitrare për atë se kush mundet ose nuk mundet të organizojë demonstrata. Në vend të kësaj, kjo i mundëson pushtetit paanshmëri dhe objektivitet në mbështetjen e ligjeve. Me procesin e dhënies së lejeve secili mund t'i ndjekë rregullat e njëjta.
3. Ligjet patjetër duhet të jenë të zbatueshme me qëllim që të jenë efektive. Masat për nga natyra janë jostabile, ndërsa demonstratat publike lehtë mund të shndërrohen në masë të dhunshme të njerëzve. Kërkimi i lejes nga policia paraqet mjet të dobishëm për rregullimin e vendeve publike. Po ashtu kjo krijon edhe kornizë racionale në të cilën edhe pushteti edhe demonstruesit mund të marrin vendime.
4. Kurrfarë e drejte për liri të të shprehurit nuk është absolute. Privilegji i disa qytetarëve që t'i shfrytëzojnë vendet publike për t'u mbledhur dhe për t'i shprehur qëndrimet e tyre patjetër duhet të rregullohet për të mirën e të gjithë qytetarëve. Kërkimi i lejes për demonstratë publike i mundëson pushtetit që ta ruajë mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve.
5. Vendi publik nuk është edhe vend ku sundon parregullsia. Rrugët u takojnë njerëzve, por nga secili qytet pritet që ta kontrollojë komunikacionin me qëllim të sigurisë publike: duhet të pengohen ata që nuk ndalen në semafor ose që insistojnë të kalojnë në këmbë nëpër rrugët urbane plot makina. Kërkimi i lejes për demonstratë publike është zbatim i ngjashëm i fuqisë së pushtetit me qëllim të mbrojtjes së sigurisë publike.
6. Ndonëse ngjarjet në botën tonë zhvillohen shpejt, pushteti po ashtu shpejt mund të përgjigjet me qëllim që t'i përmbushë nevojat legjitime të qytetarëve për liri të të shprehurit. Në rrethana pak më tjera, pushteti mund të funksionojë më ndryshe: gjykatat dhe zyrat janë tërë kohën të hapura, ndërsa policia është çdoherë në krye të detyrës. Në kohën e internetit dhe lajmeve 24-orëshe leje nga pushteti mund të merret shumë shpejt, gjithë kjo me qëllim që të mundësohen tubime dhe demonstrata publike.



Demonstratat publike – Çështje për diskutim të argumentuar me argumente të parashtruara

A duhet të ketë demokracia jonë fuqi që t'i ndalojë demonstratat publike pa leje?

Argumente për kundërshtimin e çështjes së diskutimit të argumentuar

1. Ligji që ndalon demonstrata publike pa leje e mohon lirinë elementare të një shoqërie demokratike. Njerëzve që tubohen qetë që të diskutojnë ose të protestojnë kundër diçkaje nuk u duhet leje nga ai pushtet me të cilin ndoshta kanë problem.
2. Vendimi se a duhet të lejohen ose ndalohen demonstratat publike në thelb është vendim politik. Njerëzit që kanë botëkuptime konvencionale ose që jetojnë jashtë rrugës së vizatuar në shoqëri thuajse edhe nuk mund të presin ta fitojnë qasjen e njëjtë në sipërfaqet publike si ata njerëz që e mbështetin pushtetin e vendosur. Vendimi se a do të lejohet ose refuzohet liria elementare nuk duhet t'u lihet në dorë nëpunësve.
3. E drejta e shprehjes së lirë është e drejtë në një shoqëri demokratike, por jo secili forum është falas. Për dallim nga të pasurit dhe njerëzit e kamur që përdorin media dhe paraqiten në gazeta e televizione, demonstratat publike janë lajmet dhe reklammat mediale për të varfrit, radikalët dhe njerëzit e marginalizuar. Demonstratat publike u mundësojnë demonstruesve që nuk janë të popullarizuar që të ndihmohen mes vete dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i afrojnë pikëpamjet e tyre për bashkësinë më të gjerë.
4. Marshimi dhe protestimi për nga natyra kërkojnë sipërfaqe publike ku do ta tërheqin vëmendjen kah kauza e tyre. Kërkimi i lejes nga pushteti për këto aktivitete në vende publike, madje edhe kur ruhet rendi dhe qetësia, e bën të pakuptimtë kufizimin e një të drejte themelore.
5. Qytetarët qysh moti i kanë përdorë parqet dhe vendet publike për t'u tubuar, për t'i shprehur dhe për t'i përcjellë idetë dhe vërejtjet e tyre për çështje bashkëkohore publike. Ky përdorim i këtyre vendeve ka qenë dhe patjetër duhet të llogaritet si pjesë e të drejtave dhe privilegjeve të qytetarëve. Kjo e drejtë nuk duhet të shkurtohet ose mohohet vetëm për shkak të lejes zyrtare.
6. Paraqitja me kohë e një aktiviteti është gjithçka në jetën politike, ndërsa qytetarët nuk mund ta parashikojnë ardhmërinë. Kur ndodhë diçka, njerëzit shpesh duhet të dëgjohen dhe shikohen menjëherë, natyrisht nëse dëshirojnë që njerëzit t'i respektojnë. Kërkimi paraprak i lejes për ngjarje të papritura i pengon me sukses ato demonstrata të zhvillohen në kohën kur më së shumti nevojiten.